

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “ALBAFILM” SHA
“MBI LIGJSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”, PËR
PERIUDHËN 01. 01. 2013 - 31. 12. 2014**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “ALBAFILM” me objekt “Mbi Ligjshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare”, për periudhën 01. 01. 2013 - 31. 12. 2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.20 datë 06.03.15. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 735/11 prot, datë 06.03.2015, Raporti i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Nezir Selimi, drejtor i shoqërisë “ALBAFILM”.

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi shoqëria “Albafilm” sha, ka patur zvogëlime të kapitalit si rrjedhojë e shitjeve të pronës publike dhe transferimeve të aktiveve të saj shkak që ka sjellë pakësimin e vazhdueshëm të të ardhurave që ajo realizon. Më konkretisht për vitin 2013 kapitali i shoqërisë është zvogëluar për sipërfaqen totale prej 23,279 m², në vlerën prej 503,780 mijë lekë, dhe për vitin 2014 për sipërfaqen 20,941 m² në vlerën prej 463,502 mijë lekë, nëpërmjet shitjes së pronës shtetërore. Po gjatë vitit 2014 është bërë transferimi kapital i objektit “Korpusit kryesor i godinës së ish Kinostudios” me sipërfaqen trualli 3,593 m² dhe vlerë 77,584 mijë lekë dhe 4,394 m² sipërfaqe ndërtimore me vlerë 120,121 mijë lekë si dhe ambienti i animacionit dhe studio e zërit me vlerë 20,742 mijë lekë.

U konstatua sërish problematika e sipërfaqes në përdorim të subjektit “Marubi” me të cilin në vitin 2005 është lidhur kontratë për dhënie me qira të një sipërfaqe prej 200 m² pa pagesë, por në fakt shfrytëzon një sipërfaqe më të madhe (ndërtesë + lulishte). Nuk konstatuam përpjekje nga ana e shoqërisë për të zgjidhur statusin e këtij subjekti pavarësisht qëllimeve të njëjta në objektin e aktivitetit të tyre. **Për këtë është rekomanduar:**

- Të analizohet dhe saktësohet vlera e aktiveve (tokë dhe ndërtesë) akoma në pronësi të shoqërisë dhe t’i kërkohej Ministrisë së Ekonomisë si pronar i vetëm të rivlerësojë objektin e aktivitetit të shoqërisë Albafilm në fokusin e ndryshimeve të ndodhura në vitet e fundit, duke patur parasysh gjithmonë parimin kosto/përfitim në këtë vendimarrje.

- Të kërkohej në rrugë institucionale zgjidhja e statusit të subjektit “Marubi” referuar vlerave që promovon në fushën e filmit dhe shërbimit që realizon si mbështetës kryesor të objektit real të shoqërisë Albafilm sh.a.

Menjëherë

2. Nga auditimi i dokumentacionit të aktiveve të paraqitur nga shoqëria u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë marrë masa të plota për inventarizimin e aktiveve, janë hartuar disa “lista aktivesh të nënshkruara nga disa persona”, formale dhe që nuk i shërbejnë plotësisht procesit të evidentimit dhe ruajtjes së aktiveve. Konstatuam **që procesi i inventarizimit të aktiveve në këtë shoqëri nuk është kryer ndër vite**, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Rezultoi se nuk është bërë asnjë inventar fizik për arkivin e filmit, i cili sipas bilancit kontabël paraqitet me vlerën **574,488,052 lekë**,

ndërkohë që konstatuam se bobinat e filmit që ishin në pronësi të Albafilmit në momentin e krijimit, ruheshin në kushte që ndikojnë në prishjen apo humbjen e vlerave të tyre. Më e rëndësishmja është se nuk dihet me saktësi numri dhe lloji i bobinave që janë akoma gjendje në ambientet e shoqërisë. Kjo pasuri e madhe kombëtare jo vetëm është e painventarizuar por konstatuam se ruhet në kushte tejet të papërshtatshme dhe degraduese të cilat tregojnë jo vetëm papërgjegjshmëri administrative por flasin për rrënim të ndërgjegjes kombëtare të njerëzve të cilët patën në dorë të administronin këtë pasuri.

Ndërsa për inventarët e rekuizitës u konstatuan përpjekje të drejtimit (në vitin e fundit) për ta inventarizuar, pastruar dhe vendosur në raftet por kjo ishte shoqëruar me një kosto tejet të lartë dhe të pajustificuar financiare. Janë kryer inventarë fizikë vetëm për vlerën prej **13,893,793 lekë** kryesisht kostumeri por se fletët e inventarit nuk kishin të gjithë elementët e nevojshëm, për të mundësuar krahasimin me të dhënat kontabël, kjo dhe për faktin se nga shoqëria nuk janë mbajtur ndërh vite librat dhe kartelat e magazinës, si dhe nuk është kryer rakordimi kontabël. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të realizuar verifikimin e gjendjes fizike të aktiveve qarkulluese që ka në pronësi, aktive që në vetvete përfaqësojnë atë që është historia e kinematografisë shqiptare, vlerë e pazëvendësueshme dhe e parikuperueshme dhe që i shërben memories kombëtare. Evidentimin e diferencave midis gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël duke e shoqëruar këtë proces me përcaktimin e përgjegjësiave administrative dhe penale për personat të cilët me veprimet dhe mosveprimet kanë sjellë në një situatë dramatike të administrimit të këtyre vlerave të paçmuara.

Menjëherë

3. Nga auditimi i lëvizjeve të inventarit si dhe nga dokumentacioni i inventarizimit të aktiveve rezultoi se, janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive gjithsej në vlerën **1,094,979 lekë** pa zhvilluar asnjë procedurë, pa mbajtur procesverbal nga komisioni i miratuar për nxjerrje jashtë përdorimi, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Shoqëria të marrë masa që të përcaktojë në mënyrë korrekte dhe në përputhje me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” një procedurë të shkruar për nxjerrjet jashtë përdorimit të aktive të saj si dhe personat përgjegjës që do të sigurojnë dhe garantojnë realizimin me përgjegjshmëri të këtij procesi.

Menjëherë

4. Nga auditimi i lëvizjeve të inventarit në magazinë rezultoi se nuk janë mbajtur librat dhe kartelat e magazinës. Veprimet nuk regjistrohen në mënyrë kronologjike, daljet nga magazinat nuk bëhen me urdhër dorëzimi dhe sipas kërkesave të sektorëve, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjatë auditimit, u konstatua se, lista e materialeve të ish-muzeut Enver Hoxha të ardhura nga QNK, me rreth 467 artikuj dhe vlerë 117,789 lekë, nuk ishin bërë hyrje në magazinë si dhe nuk kishte bashkëngjitur procesverbal të marrjes në dorëzim nga QNK. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Shoqëria të merren masa për të saktësuar dhe evidentuar lëvizjen e vlera materiale dhe të “objekteve inventar”, plotësimin e dokumentacionit shoqërues që rezultoi me probleme gjatë auditimit si dhe regjistrimin kronologjik të ngjarjeve ekonomike.

Vazhdimisht

-Të merren masa me qëllim evidentimin e menjëhershëm të materialet e ardhura nga Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, sipas listës që disponohet në shoqëri dhe në rastin e konstatimit të

mungesave, ato të trajtohen si materiale me vlera muzeale dhe përgjegjësia të kërkohej deri penalisht.

Menjëherë

5. Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës konstatohet se, vendimet e këtij Këshilli janë hartuar formalisht, pasi nuk kanë pasqyruar asnjë mbështetje ligjore për marrjen e tyre, në çdo rast është bërë vetëm miratimi i shkresave apo kërkesave të Administratorëve të shoqërisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin e ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrin masa për të plotësuar praktikat dokumentare të veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës dhe vendimmarrjes së deritanishme të tij, si dhe në vijimësi të vepohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin e ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, Funksionimin dhe Shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”.

Menjëherë

6. Nga auditimi mbi hartimin e miratimit të projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitet 2013 dhe 2014 konstatohet se, janë tejkaluar afatet e hartimit dhe të miratimit të tij, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të METE-s nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”. Projektprogramet e shpenzimeve për vitin 2014 nuk janë hartuar dhe mbështetur në tregues reale, pasi formularët e identifikimit të shpenzimeve janë plotësuar në mënyrë formale, fakt që konstatohet gjatë zbatimit të tyre. Kështu në zërin “Restaurim i Korpusit” vihet re një rritje e ndjeshme, nga një fond prej 31 milion lekë i parashikuar, në fakt për këtë objekt janë kryer shpenzime në vlerën prej 40,890 mijë lekë, me një tejkalim prej 9,891 mijë lekë, ose 31 % më tepër sa programi. Po kështu në zërin “blerje mobilie e orendi” sipas programit ky shpenzim është parashikuar në shumën 1,500 mijë lekë në fakt janë shpenzuar 5,640 mijë lekë, me një tejkalim prej 4,150 mijë lekë, ose 3,76 herë më tepër se parashikimi dhe në zërin mjet transporti nga 3.500 mijë lekë të parashikuara në program janë shpenzuar 4,366 mijë lekë, me një tejkalim prej 866 mijë lekë, ose 24,7 % më tepër. U konstatua se edhe miratimi i rezultati financiar të vitit 2013, nuk është paraqitur në afat në Këshillin Mbikëqyrës. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Administratori të merren masa për hartimin dhe paraqitjen në kohë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe më pas në Ministri, treguesit e programeve të zhvillimit ekonomik, të shoqëruara këto me shpjegime të hollësishme për secilin prej tyre në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të METE-s nr. 315, datë 08.04.2009, i ndryshuar.

-Të merren masa që në të ardhme në rastet e tejkalimeve të treguesve ekonomikë të bëhet miratimi i tyre nga Këshilli Mbikëqyrës, duke e shoqëruar këtë vendimarrje me një analizë të shkaqeve për këto ndryshime, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, Udhëzimin e Ministrit të METES nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime” dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sipas kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Udhëzimit të Ministrit të METE-s nr. 315, datë 08.04.2009, i ndryshuar.

Vazhdimisht

7.a Nga auditimi i dosjeve dhe dokumentacionit për kontratat e nënshkruara nga “Albafilm” sh.a, lidhur me dhënien me qira të pasurisë, të administruara në arkivin e shoqërisë, u konstatua se kanë mungesa në dokumentacion, si dhe nuk janë të inventarizuara e të arkivuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9451, datë 06.11.2003 “Mbi arkivat”.

Dosjet e kontratave nuk kanë dokumentacionin ligjor të nevojshëm për monitorimin e kontratave, si: procesverbalet e hollësishme për mënyrën e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim të objektit duke përshkruar në detaje gjendjen fizike të objektit deri në fotografim të çastit, por komisionet janë mjaftuar vetëm me një përshkrim të përgjithshëm “objekti është në gjendje të mirë funksionale”, etj, veprim në kundërshtim VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar. Nga auditimi i kontratave të qerasë për sipërfaqet mbi 200 m², u konstatua se dhënia me qera e objektit “Atelie e re” me sipërfaqe 1213 m² ka patur si pjesë edhe dhënien me qera të 5 copë vinca të mëdhenj dhe 2 copë ventilatorë të mëdhenj, për të cilët nuk ka vlerë të specifikuar por as evidencë kontabël se janë në përdorim të operatorit ekonomik.

7.b Dhënia me qira e ambienteve me sipërfaqe deri në 200 m², është bërë pa u marrë miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës, veprim në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar dhe VKM nr. 54, dt. 05.02.2014, si dhe Statutin e Shoqërisë, por edhe në një mungesë të plotë të transparencës për këtë proces. Dokumentacioni i dosjeve edhe për këto kontrata nuk është i plotë dhe konstatohet se tarifa varion nga subjekti në subjekt dhe është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 529, datë 08.06.2011, duke sjellë të ardhura vjetore të munguara të llogaritura në **1,006,080 lekë** për shoqërinë, sa trajtuar më gjerësisht në faqen të Raportit Përfundimtar. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Administratori të merren masa të menjëhershme për plotësimin e dosjeve të subjekteve me të cilët janë lidhur kontrata qiraje dhe të bëhet inventarizimi dhe arkivimi i tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9451, datë 06.11.2003 “Mbi arkivat” neni 7 dhe të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar, VKM nr.54, datë 05.02.2014 dhe Statutin e Shoqërisë.

-Të saktësohet vlera e pajisjeve që kanë qenë pjesë e kontratave të qiradhënies dhe të bëhet evidentimi i saktë kontabël i tyre.

-Nga Administratori në të ardhmen dhënia me qira e ambienteve me sipërfaqe deri në 200 m², të bëhet me miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, referuar kërkesave të dispozitave nënligjore për dhënien e pasurisë me qira ose enfiteozë dhe bazuar në një procedurë të hapur konkurrimi.

-Të merren masa që të plotësohen praktikat e monitorimit të kontratave të qirasë me dokumentacionin e kërkuar nga VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014

Menjëherë

8. Nga auditimi konstatohet se, në pronësi të “Albafilm” sh.a, janë ambientet e ish shkollës së lirë ushtarake një godinë 4 katëshe, regjistruar në kontabilitet me vlerë 1,922,130 lekë, edhe pse është lënë detyrë nga auditimi i mëparshëm, nuk janë kryer veprimet në ZRPP në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr. 9407, datë 19.5.2005. Ambientet e kësaj godine janë zaptuar prej vitesh nga familjarë dhe nuk është bërë përpjekje nga shoqëria për zbatimin e procedurave ligjore, veprime në kundërshtim me legjislacionin “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Shoqëria, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Prefekturën dhe Bashkinë Tiranë të merren masa për të kryer regjistrimin e kësaj pasurie në ZRPP sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, si dhe ndjekjen e rrugëve gjyqësore për lirimin e ambienteve.

Menjëherë

9. Nga auditimi konstatohet se, pa asnjë shpjegim nuk është derdhur plotësisht në buxhet 10% i të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e pasurisë, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Shoqëria të merren masa të menjëhershme për të derdhur plotësisht në buxhet detyrimin për të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurisë, pasi të jetë saktësuar kjo vlerë me mbylljen e llogarive vjetore të vitit 2014.

Menjëherë

10. Nga auditimi i pagave konstatohet se, me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 4.02.2014 është miratuar struktura e shoqërisë me gjithsej 19 punonjës. Në strukturën e miratuar, por dhe në strukturën që ka funksionuar në vitin 2013, janë përcaktuar pozicione pune të cilat nuk përshtaten me aktivitetin e shoqërisë dhe perspektivën e saj, si shëf i marrëdhënieve me jashtë pa asnjë punonjës në varësi dhe pa asnjë aktivitet; arkitekt; piktor; etj. ***Për këtë është rekomanduar:***

- Shoqëria të marrë masa për të rishikuar strukturën organike të saj në funksion të aktivitetit që kryen aktualisht dhe ta miratojë në Këshillin Mbikëqyrës dhe nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, bazuar në një analizë të thelluar të nevojave reale për staf.

Menjëherë

11. Nga kontrolli i listë pagesave për periudhën e auditimit rezultuan se ato nuk mbaheshin të rregullta. Nuk ishin të shoqëruara me listë prezencë të plotësuar ose ishin të plotësuar me laps, me korrigjime, pa nënshkrime, etj., bashkëlidhur urdhër shpenzimeve të kryera me bankë nuk ndodhej përmbledhësja e tyre si dhe lista e kalimit të pagave sipas llogarive përkatëse të punonjësve. Në periudhën janar-qershor 2014, pagat e punonjësve janë hedhur me ndryshime krahasuar me pagat sipas kontratës, pa asnjë shpjegim, dhe me diferenca për disa punonjës, konkretisht *për dy punonjës është paguar më tepër shuma 5,000 lekë, ndërsa 15 punonjësve të shoqërisë u janë paguar më pak gjithsej 322,600 lekë.* Nga verifikimi i formularëve të sigurimeve shoqërore evidentohen emërtesa të ndryshme nga ato të strukturës së miratuar. Listëpagesat nuk janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për pagat dhe nga punonjësi i burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues, në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Shoqëria të merren masa të menjëhershme për të plotësuar me dokumentacionin e pagave, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 69-70. Të saktësohen emërtesat e punonjësve në formularët E-SIG 027, për deklarimin e punonjësve të respektohen kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, specifikisht neni 119 dhe Udhëzimi nr. 26, datë 16.4.2009, ku citohet në mënyrë eksplicite se, “*deklarimi pranë autoriteteve tatimore për personat e rekrutuar rishtazi, kryhet 48 orë në avancë të fillimit të punës nga i punësuar ndërsa, deklarimi për punonjësit e larguar duhet të kryhet brenda një afati 10 ditor, duke nisur nga dita e largimit nga puna*”.

-Të bëhen saktësimet për diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit për vitin 2014.

Menjëherë

12. Nga auditimi është konstatuar se, mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore të vitit 2013, nga shoqëria nuk është bërë plotësisht në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 22/11/2011 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël. Në shumë raste dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, nuk janë plotësuar konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se nuk jepen shpjegime të hollësishme për origjinën e krijimit dhe të ndryshimit të llogarive inventariale, të ndryshimit të kapitalit të shoqërisë, të detyrimeve debitore apo kreditore, si dhe nuk janë shoqëruar me inventarët kontabël të llogarive. Kemi konstatuar pamundësinë e përdorimit të programit kompjuterik të financës nga stafi. Nuk ka një sistem të mbrojtjes së të dhënave kështu duhej të bëhej printimi i materialeve (ditarë apo librat e kontabilitetit) dhe ruajtja e tyre sipas legjislacionit për dokumentin elektronik, procedurë që nuk është zbatuar në vijimësi. **Për këtë është rekomanduar:**

-Nga Administratori i shoqërisë dhe Sektori i Financës të merren masa të menjëhershme për të trajnuar stafin në lidhje me përdorimin e programit kompjuterik “Financa 5”, për të bërë të mundur mbajtjen e kontabilitetit në këtë bartës kompjuterik.

-Të merren masa për evidentimin e saktë dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve ekonomike të shoqërisë në kontabilitet, hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.783, datë 22/11/2011 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”. Pasqyrat financiare të shoqërohen me inventarët kontabël të llogarive dhe në fund të periudhave ushtrimore të bëhet printimi i materialeve dhe ruajtja e tyre konform legjislacionit për dokumentin elektronik.

Menjëherë

13. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2013, është konstatuar se, në pasiv të bilancit pasqyrohen “Detyrime Tatimore” në shumën **13,171,198 lekë**, në të cilat përfshihen dhe detyrime të disa viteve që nuk kanë dokumentacion justifikues, si: 10% i tatimit të qerasë në shumën 2,790,569 lekë; tatime të tjera në shumën 331,629 lekë; tatim fitimi në shumën 4,699,803 lekë dhe tatim dividendi në shumën 5,149,197 lekë. Në postin “Huamarrje të tjera afatgjata” është shuma 5,215,062 lekë, sipas shpjegimit janë dividendë të paderdhur shpjegim që nuk ka lidhje me preken e këtij posti të bilancit. **Për këtë është rekomanduar:**

- Nga Administratori i shoqërisë dhe Sektori i Financës të merren masa të menjëhershme për saktësimin e origjinës së krijimit të këtyre detyrimeve dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronës në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të bëhet derdhja në buxhetin e shtetit e të gjitha detyrimeve ndaj shtetit.

Menjëherë

14. Konstatohet se deri në fund të vitit 2014, nga sektori i financës nuk janë bërë regjistrimet kronologjike për veprimet ekonomike, përjashtuar veprimet me arkë dhe bankë në lekë. Deri në përfundim të auditimit nga shoqëria nuk janë evidentuar shpenzimet e kryera, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve”. **Për këtë është rekomanduar:**

- Shoqëria “Albafilm”, Sektori i Financës, të marrë masa të menjëhershme për të kryer regjistrimet e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit në përputhje me ligjin nr. 9248, datë

29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 10110, datë 02.04.2009, kjo për të mundësuar një pasqyrim të drejtë të aktivitetit në cdo moment dhe për të ndihmuar vendimmarrjen e menaxherëve të shoqërisë.

Menjëherë

15. Nga auditimi rezultoi se, **menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm nuk ka funksionuar në shoqëri**, ligji për menaxhimi financiar dhe kontrollin nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj, ky sistem nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga shoqëria nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e -së; nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit; nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe nuk është caktuar nëpunësi autorizues e nëpunësi zbatues. Gjithashtu, njësia nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut; nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, etj.. **Për këtë është rekomanduar shoqërisë “Albafilm” sh.a të marrë këto masa:**

-Të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi autorizues në ministri, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm buxhetor, si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit, me qëllim që të ndihmojë njësinë, në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtejshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

-Të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Kodin Etik, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë. me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave, të caktojë nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin si dhe të caktojë nëpunësin zbatues.

-Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, shoqëria të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

-Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar këtë njësi. Gjithashtu, shoqëria të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

-Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

-Të marrë masa që në ardhmen të parashikojë përmirësimin e sistemit të IT-së, me qëllim zhvillimin e tij në funksion të rritjes së sigurisë së të dhënave për të gjithë format e raportimit që mbulon shoqëria.

Menjëherë dhe vazhdimisht

16. Në tenderin me objekt *“Restaurimi dhe rikonstruksioni i Kompleksit ish Kinostudio Shqipëria e Re”*, autoriteti kontraktor ka zgjedhur procedurën “Konkurrimin publik”, në mënyrë manuale, jo në sistemin elektronik të APP, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 45, datë 21.1.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike”. Autoriteti kontraktor në DS, ka miratuar kritere në **kundërshtim** me Udhëzimin e Ministrit të MTKRS datë 446, datë 5.7.2007, duke i tejkaluar ndjeshëm, në dëm sigurimit të mirëpërdorimit të fondeve publike, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e konkurrimin, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë etj. Për më tepër, në kriteret për kualifikim, në licencat profesionale të shoqërisë janë kërkuar kategori të punimeve, *vlera e të cilave është më e lartë edhe se sa vet fondi gjithsej në dispozicion, ose zëra punimesh që nuk kanë lidhje me zërat e punimeve të parashikuar në preventiv, të cilat e komprometojnë tërësisht procesin e konkurrimin.* **Për këtë është rekomanduar:**

- Autoriteti kontraktor në përdorimin e fondeve në dispozicion, të përdorë procedurën e prokurimit të parashikuar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe dispozitat e tjera në zbatim të tij. Përdorimi i çdo procedure tjetër, përveç sa parashikon ky ligj, të jetë i kujdesshëm dhe i argumentuar në mbështetje të VKM nr. 216, datë 18.4.2007 dhe udhëzimeve dalë në zbatim të tij.

Vazhdimisht

17. Për vitin 2013 shoqëria nuk ka mbajtur librin e aktiveve, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” KREU III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” pika 26 deri në 33 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të

cilat siguron të ardhura. Regjistrimi mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.
Për këtë është rekomanduar:

-Shoqëria, të marrë masa të menjëhershme për të plotësuar regjistrin e aktiveve, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të amortizimit, dhënien me qira, datën e daljes nga pronësia, etj.

Menjëherë

18. Nga sektori i financës janë kryer veprime me para në dorë në shuma të mëdha, si dhe është mbajtur një gjendje e lartë e arkës, pasi Administratori nuk ka përcaktuar limitin e arkës, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga Administratori të merren masa të menjëhershme për të përcaktuar limitin e arkës. Në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 63, ku thuhet: “Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës....me akte të veçanta sipas njësive publike”.

Menjëherë

19. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Veprimet e kryera për blerjet e mallrave, materialeve dhe kryerja e shërbimeve, të cilat janë likuiduar me arkë dhe bankë, nuk janë kryer me sistemin elektronik të APP-së, si dhe u konstatuan copëzime fondesh sa trajtuar në faqen e Raportit të Auditimit. ***Për këtë është rekomanduar::***

-Nga Administratori të merren masa të menjëhershme që procedurat e blerjeve me vlera të vogla të kryhen nëpërmjet sistemit elektronik, kërkesë e VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

20. Nga auditimi rezultoi se nga 17 rekomandime të lëna gjithsej nga auditimi i mëparshëm, 3 rekomandime janë zbatuar, 7 rekomandime janë zbatuar pjesërisht e janë në proces dhe 7 rekomandime nuk janë zbatuar. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga shoqëria “Albafilm” sha, të merren masat e duhura për të analizuar shkaqet dhe përgjegjësitë për mosrealizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, si dhe zbatimin e tyre në të ardhmen. Shoqëria të marrë masa të vazhdojë të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve që i kanë subjektet.

Menjëherë

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1.a Për periudhën janar- tetor të vitit 2013 janë marrë punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore të përsëritura disa herë brenda vitit, për të cilët është paguar një fond prej 730,520 lekë, pa marrë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës, nga të cilët janë paguar si pjesëmarrës

në procedura tenderimi 3 prej tyre në shumën 90,000 lekë. Nga administratori janë lidhur kontrata dhe janë paguar pa asnjë justifikim për punën e kryer.

1.b Për periudhën nëntor-dhjetor të vitit 2013 janë marrë punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore, për të cilët është paguar një fond prej 839,817 lekë, pa marrë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës. Grupit të Auditimit ju paraqit vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 16/1, datë 01.11.2013 për marrjen në punë të punonjësve me kontrata part-time me një fond prej 3 milion lekë, për të kryer sisteme, për inventarizimin e pasurisë, etj, ndërkohë që po kryhej restaurimi dhe sipas dokumenteve.

Gjithashtu me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1/1, datë 20.01.2014 është miratuar marrja e punonjësve me kontrata të përkohshme pune po me një fond prej 3 milion lekë, sipas kërkesës së Administratorit të shoqërisë nr. 3/1, datë 09.01.2014. Shkresat e mësipërme dhe vendimet e paraqitura janë të njëjtë si nga formulimi dhe përmbajtja, vetëm se ndryshojnë në data dhe për më tepër përfshijnë në to dhe punonjës që nuk kanë qenë në marrëdhënie pune me shoqërinë në datat e hartimit të tyre, lë vënd për dyshime rreth këtij dokumentacioni. Ndërkohë marrja në punë e punonjësve me kontratë part-time si, arkitekt, specialist finance, jurist, krahas atyre të miratuar në strukturë, pa asnjë justifikim, si dhe 21 punëtorë magazine, është bërë e paargumentuar dhe duke mos justifikuar punën e kryer. Puna e kryer nga këta punonjës nuk justifikohet, pasi nuk ka asnjë informacion, apo ndonjë raport pune për këta punonjës që merren me kontrata provizore, **duke rënduar padrejtësisht shpenzimet në shumën 2,470,016 lekë. Për këtë është rekomanduar:**

- Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **820,520 lekë** nga ish Administratori z. Fatmir Musaj, dhe në cilësinë e nëpunësit Autorizues, pasi për vitin 2013 ka marrë punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore dhe ka lejuar përfitimin e pagës nga 16 punonjës për punë të padokumentuar, dhe z. [REDAKTUAR] për vlerën **839,817 lekë** për marrje punonjës me kontrata provizore dhe punë të pakryer dhe pa miratim të Këshillit Mbikëqyrës, trajtuar më hollësisht në faqen 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,470,016 lekë** nga ish Administratori z. [REDAKTUAR], dhe në cilësinë e nëpunësit Autorizues, pasi ka marrë punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore dhe ka lejuar përfitimin e pagës nga 27 punonjës për punë të padokumentuar, të pakryer dhe pa miratim të Këshillit Mbikëqyrës.

Menjëherë

2. Nga auditimi i veprimeve me arkë dhe bankë u konstatuam pagesa të cilat ishin të pajustificuara me dokumentacion dhe të realizuara jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 2/a “Prokurimi me vlerë të vogël” duke nënkuptuar jo vetëm parregullsi por edhe fiktivitet të realizimit të blerjes së mallrave dhe shërbimeve. **Për këtë është rekomanduar:**

- Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **3,095,460 lekë, nga z. [REDAKTUAR], me detyrë ish-administrator dhe znj. [REDAKTUAR], me detyrë ish-shefe finance për sa kryer pagesa për blerje me vlera të vogla gjatë vitit 2013, pa dokumenta justifikuese..**

Menjëherë

- Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **223,120 lekë, z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-administrator i shoqërisë dhe znj. [REDAKTUAR] me detyrë shefe finance, [REDAKTUAR] me detyrë arkëtare-magaziniere, [REDAKTUAR] kryetar komisioni për sa kryer pagesa për blerje me vlera të vogla të padokumentuara.**

Menjëherë

3. Nga auditim i transaksioneve të bankës rezulton se janë likuiduar **3,342,463 lekë** për gjobë pagesë e vonuar TAP, sigurime shoqërore e tatim fitimi. Gjobat i takojnë vlerës prej 808,824 lekë për sigurime shoqërore dhe 12,030,526 lekë diferenca në tatim fitimin e viteve nga 2009 deri në vitin 2013. Pagesa prej 3,342,463 lekë përbën dëm ekonomik. ***Për këtë është rekomanduar::***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **3,342,463 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-administrator i shoqërisë dhe znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish shefe finance për sa paguar gjobë në favor të Degës Tatim Taksave, Tiranë për mos derdhje në afat të detyrimeve financiare që ka shoqëria ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

4. Nga auditimi i veprimeve të bankës rezultoj se blerja e një muldingpur (gomë speciale) në vlerë 324,000 lekë nuk ka preventiv, nuk ka procesverbal të komisionit marrjes në dorëzim dhe blerja është kryer sipas urdhrit të titullarit të datës 31.03.2014 dhe urdhrit të prokurimit të datës 28.03.2014. Ky material është bërë hyrje në magazinë në datën 01.04.2014, por nuk është përdorur, çka tregon se blerja është kryer jashtë nevojave të shoqërisë, përdorur pa efektivitet dhe duke rritur në mënyrë të panevojshme gjendjen e mallrave stok në magazine. ***Për këtë rekomandojmë:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **324,000 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] për sa urdhëruar blerje malli të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tij për aktivitetin e shoqërisë për sa likuiduar një blerje të padokumentuar sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë

5. Nga auditimi i procedurës së blerjes së makinës me vlerë 4,365,600 lekë, u konstatua se, në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës së lidhur me objekt “Furnizim autoveturë” është marrë në dorëzim një automjet me 90,385 km, nga 10,000 km të kërkuar. Po kështu nga fotografite në momentin e marrjes në dorëzim, rezulton se automjeti është i goditur në pjesën e prapme. Veprimet e mësipërme i kanë shkaktuar një dëm ekonomik shoqërisë minimalisht vlerësuar në shumën 1,565,600 lekë trajtuar në faqen 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **1,565,600 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-administrator, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, pasi kanë pranuar marrjen në dorëzim të autoveturës së blerë me 92,000 km në kundërshtim me specifikimet teknike

Menjëherë

6. U konstatua likuidimi i vlerës 1,386,000 lekë, pagesë sipas aktmarrëveshjes së ndërmjetësimit datë 07.04.2014. Aktmarrëveshja e lidhur kishte objekt ndërmjetësimin e detyrimit për subjektin “Jori” shpk, është bërë pa miratim të Këshillit Mbikëqyrës dhe rezulton se është krejtësisht e paargumentuar dhe e pajustificuar, pasi shoqëria në strukturën e saj organizative ka të punësuar edhe dy juristë me kohe të plotë dhe një jurist tjetër me kontratë të përkohshme. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,458,000 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] duke qënë se jo vetëm nuk është marrë miratim i Këshillit Mbikëqyrës por është konstatuar se nuk ka patur asnjë rezultat për uljen e detyrimit.

Menjëherë.

7. Nga auditimi i dietave u konstatuan parregullsi të lidhura me përfitime nga punonjës jo më në institucion si në rastin e një udhëtimi në Rusi në datat 6-10 dhjetor 2013, ku ish-administratori i institucionit z. [REDAKTUAR], pas largimit nga detyra ka përfituar si kosto udhëtimi shumën 180,600 lekë (1,290 euro), e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë. Ndërsa për një udhëtim në Itali në datat 21-25 shkurt 2014, rezultoj se shlyerja e paradhënies së përfituar nga z. [REDAKTUAR] nuk është bërë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga auditimi rezultoi se nuk justifikohet me dokumentacionin përkatës vlera prej 3,358 euro ose 470,120 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë. **Për këtë është rekomanduar:**

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **470,120 lekë**, nga z. [REDAKTUAR], për sa përfituar shpenzime udhëtimi e dieta jashtë vendit, pa dokumenta justifikuese dhe pa miratim të Këshillit Mbikëqyrës për udhëtimin jashtë vendit si dhe vlera **180,600 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] si përfitues pa të drejtë i shpenzimeve të këtij udhëtimi.

Menjëherë.

8. Për periudhën Janar-Tetor 2013 janë evidentuar dhe klasifikuar shpenzime të pa argumentuara për 1,683 litra gazoil dhe 747 litra benzinë të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës, për të cilën është nxjerrë përgjegjësia ndaj ish administratorit z. [REDAKTUAR] në vlerën prej **387,385 lekë me tvsh**. **Për këtë është rekomanduar::**

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **387,385 lekë me tvsh**, të cilat nuk janë justifikuar me fletë udhëtimi apo dokumenta të tjera ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Udhëzimit e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë publike”.

Menjëherë

9. Për periudhën Tetor 2013- Qershor 2014, për sasinë prej 1,109 litra diezel dhe 317 litra benzinë të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës, mban përgjegjësi z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-administrator i Institucionit ndërsa për sasinë prej 1,210 litra përdorur dhe dokumentuar në shërbim të administratës, por me dokumentacion jo të plotë që nuk raporton përdorim efektiv të karburantit për nevoja të aktivitetit të shoqërisë, përgjegjësia bie mbi ish shefen e financës znj. [REDAKTUAR]. **Për këtë është rekomanduar:**

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **368,280 lekë me tvsh**, nga z. [REDAKTUAR], dhe vlerën prej **223,386 lekë me tvsh** nga znj. [REDAKTUAR] për sa tërhequr nga magazina dhe mos justifikim me fletë udhëtimi apo dokumenta të tjera ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Udhëzimit e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë publike”.

Menjëherë

10. Nga auditimi i lëvizjeve të inventarit si dhe nga dokumentacioni i inventarizimit të aktiveve rezultoi se, janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive gjithsej në vlerën **1,094,979 lekë** pa zhvilluar asnjë procedurë, pa mbajtur procesverbal nga komisioni i miratuar për nxjerrje jashtë përdorimi, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. **Për këtë është rekomanduar:**

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **1,094,979 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR], për sa nxjerrë jashtë përdorimit **aktive jo sipas kërkesave ligjore**.

Menjëherë

11. U konstatua prishja e depozitës prej 60,000,000 lekë dhe kalimi i fondit prej 25,000,000 lekë nga llogaria likuiduese e [REDAKTUAR] në llogarinë likuiduese pranë [REDAKTUAR] me urdhër titullari të datës 01.04.2013. Me datë 15.04.2013 shoqëria “Albafilm” sha ka bërë kalim e kësaj vlere nga llogaria likuiduese në depozitë me afat 3/mujor, pa miratim të Këshillit Administrativ dhe pa asnjë ofertë për një kurs preferencial interesi në ndonjë bankë tjetër, në kundërshtim me statutin e shoqërisë neni 11, “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës” pika 11.8. Nga përlllogaritjet e bëra, bazuar në interesin e depozitave të [REDAKTUAR] për këtë periudhë rezulton se shoqërisë i është shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 500,000 lekë. **Për këtë është rekomanduar:**

Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **500,000 lekë**, nga z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-administrator i institucionit për sa urdhëruar veprimin e mësipërm si pasojë e të cilit shoqëria ka pësuar një humbje nga diferenca e kurseve të këmbimit dhe kostove të transaksionit të realizuar.

Menjëherë

12. U konstatua likuidimi i vlere 706,000 lekë, si materiale të ndryshme dhe shpenzime transporti, materiale elektrike, duralumin, dyer të brendshme etj. të lidhura me rikonstruksionin e godinës ku janë vendosur zyrat e shoqërisë. Ky shpenzim mbetet i pa argumentuara dhe i pajustificuara si për kohën e ndodhjes edhe për arësyen e realizimit, fakt që nuk ndryshoj edhe pas ballafaqimeve pranë zyrave të KLSH. Në praktikën e kësaj blerje nuk ka procesverbal të marrjes në dorëzim dhe nuk janë bërë hyrje shtesat e aktiveve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” çka përbën dëm ekonomik për shoqërinë. Fatura është firmosur nga z. [REDAKTUAR] duke e shtuar atë në personat përgjegjës për këtë likuidim. **Për këtë është rekomanduar:**

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **706,000 lekë**, nga ish Administratori z. [REDAKTUAR] si urdhërues i shpenzimit dhe z. [REDAKTUAR] për sa firmosur dhe miratuar faturën në funksion të likuidimit të këtij shpenzimi fiktiv.

Menjëherë

13. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **22,420 lekë**, nga ish Administratori z. [REDAKTUAR] për sa përfituar rimbursim të plotë të shpenzimeve me celular edhe në rastet që faturat e shpenzimeve faktike kanë qenë më të vogla se vlera që mbulon shoqëria “Albafilm”, duke përfituar më tepër vlerën prej **22,420 lekë**.

Menjëherë

14. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **83,507 lekë**, nga ish Administratori z. [REDAKTUAR] për sa përfituar rimbursim të plotë të shpenzimeve me celular edhe në rastet që faturat e shpenzimeve faktike kanë qenë më të vogla se vlera që mbulon shoqëria “Albafilm” në vlerën prej 63,107 lekë dhe nënshkruar faturën për blerje me vlera të vogla prej 20,400 lekë blerje libra të ndryshëm pa u bërë hyrje në magazine.

Menjëherë

15. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **75,000 lekë**, nga ish Administratorja znj. [REDAKTUAR], për sa përfituar rimbursim të plotë të shpenzimeve telefonike me celular në vlerën prej 15,000 lekë në muaj pa paraqitur asnjë faturë

për bisedat telefonike të kryera për llogari të shoqërisë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26.

Menjëherë

16.a Nga auditimi i kontratës së lidhur ndërmjet “Albafilm” sh.a dhe operatorit ekonomik “██████” sh.p.k, me objekt “Restaurimin dhe Rikonstruksion e Kompleksit Albafilm sh.a, ish-Kinostudio Tiranë, Monument Kulture kategoria II”, në drejtim të dokumentacionit teknik të dosjes së ndërtimit, librezës së masave dhe vizatimeve teknike të projektit, rezultoi se subjekti që ka përfituar më tepër si rezultat i punimeve të pakryera në objekt, gjithsej në vlerën **2,770,203 lekë pa t.v.sh.** duke mos kryer punime të cilat janë parashikuar në kontratën bazë dhe të pasqyruar në situacionin nr 4, situacionin e fondit rezervë dhe librin e masave.

16.b Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së ndërtimit, librezës së masave dhe vizatimeve teknike të projektit, janë konstatuar diferenca punimesh në zërin F.v Dritare Druri dekorative gjithsej për sasinë 19.6 m2 ose shprehur në lekë **431,180 lekë pa t.v.sh.**

16.c Nga auditimi i pagesave të realizuar për kontratën me objekt “Restaurimin dhe Rikonstruksion e Kompleksit Albafilm sh.a, ish-Kinostudio Tiranë, Monument Kulture kategoria II”, u konstatua se me urdhër të ish administratorit ██████████, është ekzekutuar pagesa për dhënien e paradhënies subjektit “██████” sh.p.k. kontraktor i tenderit në masën **15,160,882 lekë**, 20 për qind të vlerës së kontratës lidhur midis palëve, në kundërshtim nenin 9 “Pagesa paraprake” të “Kushtet e kontratës së restaurimit”, ku përcaktohetpërqindja e pagesës paraprake do të jetë 10 për qind e vlerës totale të kontratës ...U konstatua se në fund të kontratës operatorit ekonomik i ishte paguar më tepër **1,209,587 lekë**, si pjesë të paradhënies së pa ndalur. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Shoqëria t’i bëjë me dije Ministrisë së Kulturës detyrimin në lidhje me përfitimin për punime të pakryera të operatorit ekonomik “██████” sh.p.k, në zbatimin e kontratës së punimeve të ndërtimit në objektin “Restaurimin dhe Rikonstruksion e Kompleksit Albafilm sh.a, ish-Kinostudio Tiranë, Monument Kulture kategoria II” dhe të adresoj rekomandimin në lidhje me verifikimin e plotë bazuar në dokumentacionin e marrjes në dorëzim dhe arkëtimin e shumave që realizojnë të përfituara pa të drejtë nga ky operator.

Menjëherë.

17. Gjatë llogaritjes së fondit limit nga zj. ██████████, në cilësinë e hartueses së preventivit, ka vendosje të gabuar të numrit të analizës dhe çmimit për zërin e punimeve “Ndërtim çati konstruksion metal, me tjegulla marsejeze h>12 m”, me numër rendor 21 dhe nr. Analize 248/a, rezultat i së cilës është rritja padrejtësisht e vlera e preventivit 1,623,024 lekë gjithashtu për të njëjtin zë punimesh, në katër raste, çmimi sipas preventivit është më i lartë se sa ai i parashikuar në manual, e cila është shoqëruar me rritje të padrejtë të preventivit prej 422,826 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, shuma të cilat përbëjnë dëm për shoqërinë. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,045,850 lekë** nga subjekti privat “██████████”, për sa vendosur në mënyrë të gabuar referencë me efekte negative për shoqërinë, duke rritur parejtësisht koston e **objektit** “Restaurimi dhe rikonstruksioni i Kompleksit ish Kinostudio Shqipëria e Re”.

Menjëherë

18. Bazuar në gjetjet dhe konstatimet e këtij auditimi si dhe faktit që ekspertët kontabël, në përmbushjen e misionit të tyre për certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2013, kanë dhënë siguri të arsyeshme mbi aktivitetin e shoqërisë “Albafilm” sh.a duke u shprehur se pasqyrat japin një pasqyrë të vërtetë të pozicionit financiar të shoqërisë konkludojmë që ekspertiza është

realizuar formalisht dhe nuk ka plotësuar misionin e përcaktuar në Urdhrin e Ministrit (pronarit) dhe në kontratën midis palëve, për sa më sipër vlera e pagesës së tyre **1,240,000 lekë**, konsiderohet si shpenzim fiktiv dhe një dëm ekonomik për shoqërië. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,240,000 lekë** nga ekspertët kontabël znj. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR], për përfitim të padrejtë.

Menjëherë

19. Nga auditimi i konsumit të karburantit u konstatuan parregullsi në dokumentim të konsumit të tij si dhe veprime fiktive lidhur me një sasi prej 396 litrave naftë. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik, në vlerën prej **73,656 lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi magazinierja [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish Administratores për mosdokumentim dhe argumentim të naftës së shpenzuar.

Menjëherë

20. U konstatuan veprime të gabuara në largimin dhe marrjen e punonjësve në punë, gjatë periudhës korrik deri tetor 2014, të cilat janë shoqëruar me dëm ekonomik në shumën 1,405,387 lekë për buxhetin e shoqërisë. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik, në vlerën prej **1,405,387 lekë** nga ish administratorja znj. [REDAKTUAR] e cila ka vepruar në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, date 06.08.2014, duke rritur artificialisht organikën me 15 punonjës

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandojmë Administratorit të Shoqërisë “Albafilm” sha të nisë procedurat për dhënien e masës disiplinore “NDËRPRERJEN E MARRDHËNIEVE TË PUNËS”, për të gjithë personat e përmendur në këtë Raport Auditimi si përgjegjës të keqadministrimit të vlerave që ka shoqëria në dispozicion si dhe deri në një vendimarrje tjetër të pronarit nga ana e shoqërisë të mbahet vetëm një nivel stafi i domosdoshëm për manaxhimin e shoqërisë.

Menjëherë

E. KALLËZIM PENAL

Për të meta, mangësi dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik të konstatuara në auditimin e kryer në shoqërinë “Albafilm”sha të kallëzohen në Prokurori ish Administratorët

z. [REDAKTUAR] ish administrator për periudhën deri në shtator 2013,

Nga veprimet dhe mos veprimet e tij, lidhur me saktësimin e sipërfaqeve të dhëna me qira sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik dhe sipërfaqet që faktikisht kanë në përdorim këto subjekte, duke lejuar që vetëm për periudhën objekt auditimi shoqërisë ti mungojnë të ardhura në nivelin prej 26,7 milionë lekë në vit.

Nga veprimet dhe mos veprimet e tij, dhënia e ambienteve me qira për sipërfaqet deri në 200 m² është bërë pa marrë miratimin e Këshillit Mbikqyrës dhe **pa procedura konkurimi të hapur**. U konstatua se niveli i cmimit për m² për këto sipërfaqe varion nga 134 lekë/m² deri në 513 lekë/m², tarifa të cilat bien në kundërshtim me vlerën e përcaktuar në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar. Për shkak të përdorimit të tarifave të diferencuara shoqërisë i është shkaktuar një nivel mungese në të ardhura prej **1,006,080 lekë** në vit.

Për periudhën kur ka drejtuar këtë institucion nuk ka marrë masa për inventarizimin e aktiveve, veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Shoqëria duhet të kontrollonte të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Nuk është bërë asnjë inventar fizik për arkivin e filmit, i cili sipas bilancit kontabël paraqitet me vlerën 574,488,052 lekë. Kjo pasuri e madhe kombëtare jo vetëm është e painventarizuar por konstatuam se ruhej në kushte tejet të papërshtatshme dhe degraduese të cilat tregojnë jo vetëm papërgjegjshmëri administrative por flasin për rrënim të ndërgjegjes kombëtare të njerëzve të cilët patën në dorë të administronin këtë pasuri.

Në cilësinë e administratorit ka neglizhuar pagimin e saktë të detyrimeve ndaj shtetit dhe detyrimeve tatimore. Nga kjo neglizhencë vetëm për mos pagim të saktë të detyrimit tatimor shoqëria “Albafilm” sha, ka paguar gjoba për organet tatimore në vlerën prej **3,342,463 lekë**. Ndërsa vlera e papaguar e detyrimeve tatimore kalonte nivelin e 12 milionë lekëve, gjithashtu konstatohet e njëjta neglizhencë në pagimin e detyrimeve ndaj Pronarit (ish METE) si për taksën mbi qeratë dhe nivelin e dividendit të deklaruar në vite nga aktiviteti i shoqërisë.

Në cilësinë e autorizuesit të pagesave ka lejuar të kryhen likuidime për blerje të vlerave materiale dhe shërbime të ndryshme pa kërkesë nga sektorët përkatës, pa procesverbal të mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, si dhe një pjesë e konsiderueshme e vlerave materiale janë bërë hyrje në magazinë pa procesverbal nga komisionet e marrjes në dorëzim të vlerave materiale, duke lejuar edhe veprime fiktive në lëvizjen e këtyre vlerave materiale, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 2/a “Prokurimi me vlerë të vogël” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 “Për blerjet me vlerë të vogël”, udhëzimit nr. 1, datë 09.03.2011, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën **prej 3,928,960 lekë**.

Ka përvetësuar pa asnjë vendim të Këshillit Administrativ duke dokumentuar fiktivisht daljen për skrap të automjetit me vlera muzeale tip “Zim” (vlerë kontabile **224,249 lekë**). Në fletëdaljen e administruar për këtë transaksion është shënuar se automjeti merret për skrap me destinacion “shkozet” Durrës. U konstatua se, për këtë mjet magazinieri [REDAKTUAR] ka prerë fletë daljen nr. 12, datë 09.04.2013, në të cilën është shënuar se, Autovetura tip “Zim” shkon për skrap”, ndërkohë që tek dokumenti i transportit është vendosur shënimi Benz [REDAKTUAR], fakt që tregon fiktivitetin dhe tregon për shpërdorim të detyrës si nga ish Administratori edhe magazinieri.

Në cilësinë e Administratorit ka marrë 16 punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore dhe ka lejuar përfitimin e pagës për punë të padokumentuar, të pakryer dhe pa miratim të Këshillit Mbikqyrës, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **1,480,337 lekë**.

z. [REDAKTUAR] ish administrator për periudhën prej tetor 2013 deri në qershor 2014

Për periudhën objekt auditimi nuk ka marrë masa për inventarizimin e plotë të aktiveve, pasi nga shoqëria janë hartuar disa “lista aktivesh të nënshkuara nga disa persona”, që tregojnë se janë formale dhe nuk i shërbejnë procesit të inventarizimit të aktiveve, veprim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Nuk është bërë inventarizimi i bobinave të filmit dhe aktiveve të trupëzuara të shoqërisë duke lënë shteg për mos administrim të mirë të pasurisë së shoqërisë.

Në cilësinë e Administratorit ka miratuar daljen jashtë përdorimit të aktive në vlerën **1,094,979 lekë** pa zhvilluar asnjë procedurë, pa mbajtur procesverbal nga komisioni i miratuar për nxjerrje jashtë përdorimi, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik për shoqërinë.

Në cilësinë e Administratorit ka marrë në punë 27 punonjës me kontrata provizore, me afate një, dy dhe tre mujore dhe ka lejuar përfitimin e pagës për punë të padokumentuar, të pajustificuar me dokumenta dhe pa një vendimarrje të mirëadministruar të Këshillit Mbikëqyrës (Vendimet (2) kanë të njëjtën përmbajtje por nga dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj vendimarrje në protokoll të con të gjykosh se njëri nga Vendimet është i fallsifikuar) duke sjellë si pasojë dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **2,470,016 lekë**.

Ka miratuar likuidimin më tepër të vlerës prej **1,565,600 lekë**, në blerjen e një autoveture me specifikime teknike të ndryshme nga ato të kërkuara në tender dhe dokumentuar në kontratën e blerjes (kështu konstatohet se është kërkuar një makinë me 10,000 km të përshkuara, në fakt komisioni e ka marrë në dorëzim me 90,000 km).

Në cilësinë e Administratorit dhe të nëpunësit autorizues ka lidhur marrëveshje dhe ka paguar një avokat në vlerën prej 1,458,000 lekë pa vendim të Këshillit Mbikëqyrës për ndërmjetësimin e uljes së një detyrimi dhe pa asnjë rezultat për uljen e detyrimit. Lidhja e kësaj marrëveshjeje është krejtësisht e paargumentuar dhe e pajustificuar, pasi shoqëria në strukturën e saj organizative ka të punësuar edhe dy juristë me kohe të plotë dhe një jurist tjetër me kontratë të përkohshme. Për sa më sipër shoqërisë “Albafilm” sha i është shkaktuar një dëm ekonomik në shumën **1,458,000 lekë**.

znj. [REDAKTUAR] ish administratore për periudhën prej korrikut 2014 deri tetor 2014

Në cilësinë e ish administratores ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.10, date 06.08.2014, pasi jo vetëm që nuk ka marrë masa për shkurtimin e organikës, po ka lidhur kontrata pune edhe me 7 punonjës të tjerë duke rritur artificialisht organikën me 15 punonjës me pasojë dëm ekonomik për shoqërinë, në vlerën prej **1,405,387 lekë**.

Në kohën që ka qënë administratore dhe ka përfituar pagë si e tillë ka rezultuar se përfitonte pension invaliditeti (të pjesshëm). Në këto kushte ka përfituar në mënyrë të padrejtë pensionin e kësaj kategorie invaliditeti. Dokumentet e administruara vërtetojnë se ajo ka qënë përfituese gjatë gjithë kohës dhe nuk ka bërë asnjë deklaram të pezullimit të kësaj të drejte për sa kohë ishte në funksionin e administratores.

Vlerësim të veprës për znj. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ekspertëve kontabël që kanë certifikuar pasqyrat financiare të vitit 2013.

Për të meta, mangësi dhe shkelje të parimeve dhe standardeve të punës së ekspertit kontabël të certifikuar në dhënien e një opinioni “certifikues” të pasqyrave të cilat jo vetëm ishin të pasakta dhe nuk tregonin me vërtetësi pamjen e shoqërisë por fshehin dhe nivelin e papërgjegjshmërisë manaxheriale në administrimin e pronës shtetërore. Kështu që gjykojmë se përfitimi nga ky shërbim **1,240,000 lekë** nga **znj. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR]**, është realizuar në kushte të mashtrimit për shërbim të pakryer apo të kryer pa cilësi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT